



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 411/2 Prot

Tiranë, më 28.04.2021

**V E N D I M**

Nr.46, datë 28.04.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Njesisë Përgjegjëse, për skualifikimin e aplikantit \*\*\*\*\* , nga pjesëmarrja në konkurrimin me kod #3435, për shkak se ka masë disiplinore në fuqi.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga nëpunësi \*\*\*\*\* , për disa veprime të njesisë, e cila e ka skualifikuar atë pa të drejtë, nga disa konkurrime ku ai ka aplikuar, duke arsyetuar se ai nuk mund të marrë pjesë në konkurrim, pasi ka masë disiplinore në fuqi.

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës,protokolluar me nr. 411 prot, datë 16.03.2021, paraqitur nga shtetasi \*\*\*\*\* , nëpunës në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë, është ngritur pretendimi se në disa raste, nëmënyrë të padrejtë, për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit, është skualifikuar nga pjesëmarrja në konkurrimin me kod #3435, me arsyetimin se ka masë disiplinore në fuqi.

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, prej dokumentacionit të mbledhur për këtë qëllim, rezulton se \*\*\*\*\* , është nëpunës civil i konfirmuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë. Ndërkaq, konstatohet se, për shkak të disa shkeljeve të konstatuara në kryerjen e detyrës, Komisioni i Disiplinës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me vendimin nr. 449 dt. 10.09.2018, ka marrë ndaj tij masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës, për një periudhë 1-vjecare”

Pasi ka përfunduar afatin një vjeçar të masës së mësipërme disiplinore, nëpunësi në fjalë ka shprehur interes dhe ka aplikuar për të marrë pjesë në konkurrimin me kod #3435, për pozicionin “Inspektor i parë, në sektorin e kontrollit në vend” në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë – kategoria III-b

Nisur nga përmbajtja e pikës 2/b të Kreut VII, të Vendimit nr. 243 dt. 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, sipas së cilës një nga kushtet minimale që duhet të plotësojë konkurenti për këtë procedurë, është: b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi, aplikanti ka kërkuar vërtetimin përkatës në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, por kjo e fundit ka shënuar në dokumentin e lëshuar se masa disiplinore e marrë me vendimin nr. 449 dt. 10.09.2018 të Komisionit Disiplinor, është akoma në fuqi, pasi shuhet vetëm pas kalimit të tre viteve nga përfundimi i zbatimit të saj.

Bazuar në vërtetimin e mësipërm, njësia përgjegjëse, duke e konsideruar të drejtë arsyetimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të DPT, ka vendosur skualifikimin e aplikantit \*\*\*\*\* , nga pjesëmarrja në konkurrimin me kod #3435.

Këtë veprim të njësisë përgjegjëse, nëpunësi në fjalë e konsideron të padrejtë, të marrë në kuptim dhe zbatim të gabuar të legjislacionit të shërbimit civil, duke ngritur pretendimin se, të kesh masë disiplinore në fuqi dhe të kesh masë disiplinore të pashuar, janë dy koncepte me kuptim të ndryshëm. Sipas tij, ekzistenca e një mase disiplinore në dosjen e personelit, ka të bëjë vetëm me efektin e përsëritjes dhe jo me të qenit në fuqi të saj. Për më tepër, ai parashtron që, nëse masa në fuqi dhe masa e pashuar do të ishin e njejtë gjë, nuk kishte arsye pse të përdreshin terma të ndryshëm.

Nisur nga këto pretendime dhe nga fryma e dispozitave që rregullojnë administrimin e shërbimit civil, arsyetojmë sa më poshtë:

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në nenin 58 të tij, ka parashikuar llojet e masave disiplinore dhe në pikat “b” dhe “c” për shkak të natyrës së masës disiplinore, edhe afatet për sa kohë mund të merret masa përkatëse. Ndërkohë, që në nenin 61, të ligjit në fjalë, janë sanksionuar afatet e shuarjes së masave disiplinore, duke mos i kufizuar efektet e masave vetëm gjatë periudhës së zbatimit, por duke përcaktuar edhe një periudhë tjetër kohore, me kalimin e së cilës masa i shuan përfundimisht efektet mbi nëpunësin.

Konkretisht, sipas dispozitës në fjalë, afatet e shuarjes së masave disiplinore dhe momenti i fillimit të ecjes së këtij afati, përcaktohen si më poshtë:

- 2 vjet nga njoftimi i vërejtjes për shkeljet e lehta;
- 3 vjet nga mbarimi i afatit, për të cilin është masa e pezullimit të ngritjes në detyrë, përfshirë dhe shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, apo mbajtjen deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj dhe;
- 7 vjet nga njoftimi i largimit nga shërbimi civil.

Afatet e vendosura si më lart, për secilën prej masave disiplinore, duhet të lexohen dhe interpretohen në mënyrë sistematike, për të gjitha llojet e masave disiplinore, të lehta, të rënda apo shumë të rënda. Për pasojë, duke iu referuar faktit se, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* është dhënë masa disiplinore e pezullimit nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshi këtu edhe rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 (një) vit, masa e dhënë në ngarkim të tij vërtet mbaron së vuajturi pas kalimit të periudhës 1 vjeçare, por ajo megjithatë, vazhdon të mbetet në fuqi dhe shuhet për shkak të ligjit, vetëm pasi të kalojë afati tre vjeçari përcaktuar në pikën “b” të nenit 61, të ligjit. Pra, ajo që duhet theksuar është se afati tre vjeçar i shuarjes fillon menjëherë pas plotësimit të afatit material të masës disiplinore.

Në këtë kuptim, mungesa e masës disiplinore në fuqi nënkupton jo vetëm mungesën e masave disiplinore që vijojnë të zbatohen (*gjatë shtrirjes së efekteve*), por edhe mungesën e masave disiplinore të pushuara sipas nenit 61, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në kuptim të sa u tha më sipër, do të thotë që veprimi i njësisë së burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila ka lëshuar vërtetimin se aplikanti në fjalë ka masë disiplinore në fuqi, është një veprim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Ky konkluzion mbetet edhe në kushtet kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 109 dt. 01.02.2019, ka vendosur shfuqizimin e masës së mësipërme disiplinore, pasi ky vendim akoma nuk ka marrë formë të prerë.

Në këtë vështrim, arrihet në përfundimin se edhe veprimi i njësisë përgjegjëse, që ka vendosur skualifikimin e aplikantit \*\*\*\*\* , për pjesëmarrje në konkurrimin me kod #3435, për pozicionin “Inspektor i parë, në sektorin e kontrollit në vend” në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë – kategoria III-b, është i drejtë, pasi në dosjen e tij personale, efektivisht, ekziston një masë disiplinore e pushuar.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Njësisë Përgjegjëse, për skualifikimin e aplikantit \*\*\*\*\* , nga pjesëmarrja në konkurrimin me kod #3435, për shkak se ka masë disiplinore në fuqিদhe arkivimin e çështjes.

Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe nëpunësit \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**